

Lënda: Minutat e takimit të parë konsultativ të draft Planit të Veprimit të OGP, komponenti I IV “Qeverisje e Hapur në Luftën kundër Korrupsionit” objektivi specifik “Planet e Integritetit”, dt. 25.09.2020.

I mbajtur sot, më dt. 25.09.2020, Online sipas Platformës Ëebex, ¹takimi i parë konsultativ i draft Planit të Veprimit të OGP, komponenti IV “Qeverisje e Hapur në Luftën kundër Korrupsionit” me objektivi specifik “*Planet e Integritetit*” midis Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesve të Kryeministrisë, ekspertes C. McLaren, OGP Canada si dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, konkretisht : ALTRI, NDI Albania, ICC Albania dhe IDM Albania.

Në këtë takim, fjalën përshëndetëse e merr znj. Pregja e cila e bëri një përshkrim të shkurtër të procesit të OGP lidhur me draft-planin e veprimit për objektivin specifik “Planet e integritetit”.

Fjalën e merr znj. McLaren, e cila theksoi domosdoshmërinë e propozimeve që mund dhe duhet të merren nga OSHC në këtë plan veprimi,

Fjalën e merr znj. Qaja, duke bërë kërkuar që bashkëpunimi në kuadër të hartimit të këtij komponenti të jetë në bashkëpunim të ndërsjellë me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Fjalën e merr znj. Karapinjalli për të bërë një prezantim të shkurtër në PPT të draftit të Planit të Veprimit të OGP konkretisht të objektivit “Planet e Integritetit” si dhe për të ndarë me përfaqësuesit e shoqërisë civile “Matricën e Prioritizimit”. Theksi në këtë takim të parë konsultativ u vendos tek rishikimi i masave të draft- PV Objektivi strategjik “Planet e Integritetit” si dhe tek ofrimi propozime të reja, konkrete lidhur me masat/aktivitetet e këtij plani.

Fjalën e merr znj. Rovenia Sulstarova, përfaqësuese e IDM e cila në këtë takim të parë konsultativ të draft-PV të OGP sugjeroi që drafti i PV të OGP për komponentin e IV “*Qeverisje e Hapur për Luftën kundër Korrupsionit*” të rishikohej, konkretisht duke propozuar; Hartimin e një metodologjie për raportin e monitorimit të zbatueshmërisë së PI; Miratimin dhe Publikimin e dokumentit të PI të MD; Takime konsultuese me Grupet e interesit/OSHC lidhur me raportin e monitorimit të zbatueshmërisë së PI; Konsultimin me Grupet e Interesit/OSHC të rekomandimeve në kuadër të gjetjeve të vlerësimit të kryer;

U la si detyrë konkrete që propozimet/komentet/sugjerimet lidhur me përditësimin e masave/aktiviteteve nga ana e grupeve të interesit/OSHC si dhe përmbushjen e elementit të prioritizimit të dërgoheshin në rrugë elektronike brenda dt. 25.09.2020 sipas formatit të miratuar të formularit të vlerësimit.

¹ <https://akshi.webex.com/akshi/j.php?MTID=mc2adac1f0e0d9536014accc3bca6253f>